




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiçan, me datë: 11.03.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiçanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **08.03.2019**, të parashtruar nga **OE K.N.T.SH. " TEUTA-M " SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët "** me nr të prokurimit **GL 651-19-698-5-2-11** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 19 015 211** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë **OE K.N.T.SH. " TEUTA-M " SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët "**, me nr të prokurimit **GL 651-19-698-5-2-11** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 19 015 211** e dt. **08.03.2019** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **27.02.2019** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjiçanit vendos të vazhdojë sipas** Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **27.02.2019**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë **OE K.N.T.SH. " TEUTA-M " SH.P.K**, me datë **08.03.2019** , ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët "**, me nr të prokurimit

GL 651-19-698-5-2-11 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 19 015 211. Autoriteti Kontraktues me datë 11.03.2019 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 27.02.2019 më saktësisht tek Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar si dhe tek Kapaciteti teknik dhe profesional :

Sipas afatit për parashtrimin e sqarimeve shtesë nga OE- lidhur me DT dhe Njoftimin për Kontratë ka pranuar pyetje lidhur me kërkesat e lartëcekura:

Pyetja 1. Duhet te ndryshohet dhe te kerkohen raportet e Deklarimit te ATK per vitet kalendarike, pasi edhe aty figuron qarkullimi vjetor I deklaruar, duke e mare parasysh qe tek Referencat keni kerkuar Referenca per Pune te tilla tri vitet e fundit para dates se dorzimit te tenderit dmth per vitet 2016,2017 dhe 2018 deri para dates se dorzimit 2019, andaj kjo nuk perkon me kerkesen per Raportet e Auditimit per vitet 2015,2016,2017- pasi po kthehet edhe nje vit mbrapa dhe sic e dijm ne Raportet e Auditimit 2018 nuk mund te jet pasi edhe kohe e shkurtet per Auditim, kurse Deklaratat e ATK-es jan te deklaruar dhe publike. Andaj kerkojme qe te ndryshohet apo te lihet mundesia edhe dorzimi I deklaratave te ATK.

Pyetja 2. Sa I perket Stafit te Injnierave te ndertimtaris dhe Gjeodezis qendrojn, kerkojme qe te shtohet edhe ing, I Hidroteknikes pasi puna apo lemia e ketij projekti eshte dhe perkon me Hidroteknik.

Ndersa sa I perket kerkeses per Teknik te ndertimtaris , ju vetem keni kerkuar nje Ing. Te Ndertimtaris dhe nuk ka nevoj per teknik pasi qe edhe projekti k ate beje me Hidroteknikdhe nuk ka ndertim te objektit, kerkojm qe te largohet kjo kerkes dhe te shtohet vetem ing. I Hidroteknikes.

Dhe kerkesa per Armirus te certifikuar, kjo nuk shkon fare me lemin dhe fushen e ketij projekti pasi qe ne pozicione te paramases se ketij projekti nuk ka fare Ndertim apo Armirim apo edhe Muratim parandaj duhet te largohet, shto ketu edhe faktin se Minisitria nuk I nostrifikon certifikata apo trajnimet, mirepo vetem diplomat universitare.

Pyetja 3. Kerkesa e Makineris:

Keni kerkuar : Kamion veteshkarkues me kran 2-2.5t

Ju e keni specifikuar sakt cfare kamioni dhe kg sa duhet te jete. Nuk mund ti kushtizoni OE se cfare peshe te kamionit mund te perdorin, ju vetem sa nuk e keni kushtezuar edhe ngjyren e kamionit se cfare te perdoret. Kamiona te till ka prej 2 deri 3 ton me norm ate prodhuara dhe andaj kerkesa duhet te jete keshu.

Keni kderkuar: 2 kamion transportues me pesh mbi 10m3

Kjo qendron pasi keta kamiona jan standart neper kompani dhe per kete lemi te puneve

Keni kderkuar: 2 kamion transportues 2 Aks me pesh 6-8ton,

Kjo nuk qendron dhe eshte absurd pasi eshte kushtezim se sa aks te jete kamioni dhe cfare rendesie ka per keto lloj pune, kur e dim se lokacioni per kete pune rruga e Kumanoves dhe komplhet deri ne Livoc jane livadhe dhe me shume pak shtepi.

Keni kerkuar: 2 Minieskavator deri 3.5t.

Te nderuar keta eskavator nuk hyjn ne pune fare per kete project, pasi qe eshte e parapar hapja e kanalit me thellesi mesatare deri 2.5m` (shih pozicionin ne paramas) kurse Minieskavatorat nuk mund te bejne kete pune fare, kjo qarte eshte me tendency.

**Keni kerkuar: 1 Eskavator me rrita zinxhirore 12ton
Edhe kjo nuk qendron dhe duhet te ndryshohet.Duhet te kerkon psh. 3 apo 4 eskavator peshave prej 7-15ton, sepse per keto pune keta eskavator perdoren sipas normave dhe specifikave, kto mund te deshmoen dhe profesionistat e dijne kete.**

**Keni kerkuar: 1 Traktor per vende te ngushta.
Te nderuar, kerkes absurd. Nuk ka rruge te ngushta fare ne rr.Kumanoves jane rrug fushore dhe komplet te hapura, kerkojme qe ta nderroni.**

**Keni kerkuar: Kompresor ajri per thyerje te betonit min. 5bar
Ne pozicionet e paramases nuk ka fare poz.per thyerjen e betonit,kjo duhet te hiqet**

**Keni kerkuar: 1 Cilinder me rrota te celikut 2-3 ton, 1 Cilinder 8-9 t, Cilindra 12t
Te nderuar keto duhet te hiqen komplet sepse shikoni mire pozicionet e paramases nuk ka askund Asfalt te shtrohet dhe sic e dijme mire lokacioni ku do te punohet sic deklarum eshte vend fushor-ara dhe rruget jan te hapura privatisht, kjo kerkes eshte e tepert dhe shume tendencioze**

**Keni kerkuar 1 cekan pneumatic dhe damber 1-t
Ne pozicionet e paramases nuk shihet hapja e kanalit edhe me cekan mirepo vetem me makineri (eskavator) pasi qe edhe kategoria este III-IV. Kjo duhet te hiqet. Dhe kerkesa per damber duhet te hiqet pasi mund te kryhet me eskavator dhe kamion.**

**Kerkesa per planin per menaxhimin e trafikut sa me te detajuar
Kjo duhet te hiqet pasi sic treguam dhe sic treguam dhe sic e dini lokacioni eshte vend fushor dhe nuk ka fare komunikacion, eshte vend shume pak I banueshem.
Andaj edhe kerkesa per ISO 39001-2012 qe ka te beje per sigurin ne komunikacion duhet te hiqet pasi nuk perkon me vendin, lokacionin dhe lemin e punes.**

AK pas pranimit të pyetjeve nga ana juaj si OE, ka bërë Korigjim të Dosjes së Tenderit si dhe të Njoftimit për Kontratë me datë 08.03.2019 duke marrë në Konsideratë pretendimet tuaja.

Andaj, përgjigjjet sa i përket pyetjeve të parashtruara i gjeni dhe në Sqarimet e Dosjes së Tenderit ku theksohet :

Përgjigjja 1 – Ju informojmë se është e drejtë e AK-se që të vendos kërkesat me të cilat mendon se janë më të sakta dhe të sigurta dhe AK e ka vlerësuar se për këtë pikë duhet të kërkohen Raportet e Auditimit.

Përgjigjja 2 – Ju informojmë se inxhinieri I Hidros apo bachelor në korigjimin e dosjes do të jetë si kërkesë e pranuar, ndërsa lidhur me teknikët e ndertimtarisë mbetet si kërkesë sic

ka qenë më herët për arsye se njësia e kërkesës e ka parë të arsyeshme që të jenë si kërkesë, ndërsa për kërkesën lidhur me Armiruesin edhe kjo mbetet e njejtë, pasi që pozicioni 4.6 ka të bëjë me këtë kërkesë.

Përgjigjja 3 – Ju informojmë se Kamioni vetshkarkues me kran korigjohet dhe bëhet nga 2 deri ne 3 ton. Ndërsa Eskavatori me rrota zingjirore 12 ton, korigjohet dhe behet nga 10 deri ne 12 ton, ndërsa kompresor ajri per thyerjen e betonit min 5 bar, hiqet si kriter, po ashtu edhe traktori per vende te ngushta hiqet nga kriteret së bashku me Mekanizmin 1 (një) damper 1-2 t, ndërsa kërkesat tjera lidhur me makinerite mbesin te njëjta.

Gjithashtu Kërkesa 9, Ku është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te jetë i pajisur me Certifikatë ISO 39001 2012, AK ne korigjimin e procedures ka larguar tersishet kete kerkese.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.